



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_. \_\_. 2025

**URDHËZIM**

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ 2025

**PËR**

**KUSHTET DHE KRITERET PËR USHTRIMIN E AKTIVITETEVE TREGTARE NË  
ZONA PUBLIKE ME VLERË ARKEOLOGJIKE, HISTORIKE, ARTISTIKE,  
KULTURORE, PEIZAZHI DHE PROCEDURA E PËRZGJEDHJES SË SUBJEKTEVE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe pikës 1 dhe 4 të nenit 102, të ligjit nr. 27, datë 17.05.2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, i ndryshuar.

**UDHËZOJ:**

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Ky udhëzim ka për qëllim:
  - a) Përcaktimin e kushteve dhe kriterëve, për ushtrimin e aktivitetëve tregtare në zona publike me vlerë arkeologjike, historike, artistike, kulturore dhe peizazhi, në administrim të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe institucioneve në varësi të saj: pushtetit vendor, subjekteve dhe individëve që kanë në administrim ose në pronësi (posedim) pasuri kulturore
  - b) Procedurën e përzgjedhjes të subjekteve për kryerjen e veprimtarive tregtare në zona publike me vlerë arkeologjike, historike, artistike, kulturore dhe peizazhi;
2. Termat e përdorura në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim sipas përkufizimeve në ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, i ndryshuar.

**II. TIPOLOGJIA E AKTIVITETEVE TREGTARE NË ZONA PUBLIKE ME  
VLERË ARKEOLOGJIKE, HISTORIKE, ARTISTIKE, KULTURORE DHE  
PEIZAZHI DHE KUSHTET PËR ZHVILLIMIN E TYRE**

1. Tipologjia e aktivitetëve tregtare që zhvillohen në zonat publike me vlerë arkeologjike, historike, artistike kulturore dhe peizazhi përfshin:

- a) shërbimi i botimeve dhe shitjes së katalogëve, fletëpalosjeve, botimeve të tjera të ngjashme, incizimeve audiovizive dhe informatike, çdo material tjetër informativ;
  - b) shërbim i shitjes së riprodhimit të pasurive (replika, souvenirë);
  - c) shërbime të pritjes, përfshirë ato të asistencës, argëtimit për fëmijët, shërbimet e informacionit, të guidave dhe asistencës didaktike;
  - d) shërbime të kafeterisë dhe ushqimit (kafeteri, pije dhe ushqim i shpejtë);
2. Aktivitetet tregtare në këto zona duhet të zhvillohen në përputhje me kushtet e mëposhtme:
- a) të garantojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave arkeologjike, historike, artistike kulturore dhe peizazhit;
  - b) të nxisin njohjen dhe promovimin e vlerave të pasurisë kulturore;
  - c) të jenë në përputhje me planin e menaxhimit të pasurisë kulturore ku do ushtrohet aktiviteti tregtar, në rast se ka;
  - d) të kontribuojnë në restaurimin e vlerave të pasurisë kulturore;
  - e) të mos dëmtojnë pamjen, dekorin, peizazhin dhe integritetin e vlerave kulturore;
  - f) të mos pengojnë aksesin e publikut në pasuritë kulturore;
  - g) të mos pengojnë zhvillimin e aktiviteteve, edukuese, studimore, kërkimore.

### **III. KRITERET PËR USHTRIMIN E AKTIVITETEVE TREGTARE NË ZONA PUBLIKE ME VLERË ARKEOLOGJIKE, HISTORIKE, ARTISTIKE, KULTURORE DHE PEIZAZHI**

1. Çdo subjekt person fizik juridik apo OJF, i regjistruar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
2. Për të ushtruar aktivitet tregtar subjekti duhet të plotësojë kriteret si më poshtë::
  - a) të jetë regjistruar si person fizik/person juridik me status aktiv, sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi për regjistrimin e veprimtarisë tregtare
  - b) të jetë i pajisur me të gjitha lejet dhe/ose licencat e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi në varësi të llojit të aktivitetit dhe kërkesës së propozuar për ushtrim aktiviteti tregtar;
  - c) Për personin fizik të mos jetë në ndjekje penale ose të mos jetë dënuar për një vepër penale në fushën e trashëgimisë kulturore dhe në fushën e aktivitetit ku ushtron veprimtarinë ekonomike, për personin juridik të merret dëshmia e penaltetit për administratorin ligjor.
  - d) të sigurojë kapacitete financiare dhe ekspertizë të nevojshme për të zbatuar aktivitetin tregtar të propozuar;
  - e) Të propozojë një aktivitet tregtar që garanton ruajtjen, mbrojtjen, promovimin dhe aksesin e publikut në pasurinë kulturore.

3. Aktivitetet tregtare referuar tipologjisë sipas pikës I, shkronja a) dhe b) e Kreut II të këtij udhëzimi, duhet të përmbushin kriteret si vijon:
- a) Të jenë replika të objekteve/vlerave me përfaqësuese të trashëgimisë kulturore që ruhen dhe promovohen në pasurinë kulturore ku do ushtrohet aktiviteti tregtar;
  - b) Të jenë riprodhim në letër, tekstil, qeramikë, plastikë, dru etj. të imazheve, objekteve/vlerave më përfaqësuese të trashëgimisë kulturore që ruhen dhe promovohen në pasurinë kulturore ku do ushtrohet aktiviteti tregtar;
  - c) Të jenë objekte funksionale me forma dhe imazhe të përshtatshme për promovimin e vlerave të pasurisë kulturore të institucionit ku do ushtrohet aktiviteti tregtar (per diskutim);
  - d) Të jenë produkte të zejtarisë tradicionale të cilët përfaqësojnë traditat kulturore autentike në materiale modele dhe mjeshtëri tipike të zonës ku do ushtrohet aktiviteti tregtar të punuara me dorë dhe teknika e mjete tradicionale të artizanatit;
  - e) Të jenë botime (libra, harta, almanakë, vjetarë, katalogë, albume, dëftues të rrugëve, broshura etj.) të pajisura me ISBN, që promovojnë vlerat kulturore të vendit tonë në përgjithësi, të pasurisë kulturore ku do ushtrohet aktiviteti tregtar dhe të rajonit ku ndodhet pasuria kulturore në veçanti;

#### **IV. PROCEDURA PËR PËRZGJEDHJEN E SUBJEKTIT PËR KRYERJEN E AKTIVITETEVE TREGTARE NË ZONA PUBLIKE ME VLERË ARKEOLOGJIKE, HISTORIKE, ARTISTIKE, KULTURORE DHE PEIZAZHI**

##### **A. Paraqitja e kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues**

1. Subjekte të interesuar mund të paraqesin kërkesë me shkrim pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore për ushtrimin e aktivitetit tregtar në zona publike me vlerë arkeologjike, historike, artistike, kulturore dhe peizazhi.
2. Kërkesa e paraqitur nga subjektet e interesuara duhet të shoqërohet me dokumentacionin si vijon:
  - a. CV të subjektit tregtar ose administratorit.
  - b. Ekstrakt historik të aplikuesit
  - c. Informacion mbi tipologjinë e aktivitetit tregtar që propozohet të ushtrohet;
  - d. Vetëdeklarim që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk është dënuar penalisht për vepra penale në fushën e trashëgimisë kulturore dhe në fushën e aktivitetit ku ushtron veprimtarinë ekonomike;
  - e. Vërtetim që subjekti nuk është subjekt i procedurave të likuidimit ose falimentit;
  - f. Vërtetim nga autoritetet tatimore se subjekti ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore;
  - g. Planvendosjen e aktivitetit tregtar të propozuar

- h. Planin biznesin për ushtrimin e veprimtarisë tregtare për një kohëzgjatje minimale 5 vjeçare, duke përfshirë parashikimin e vlerës së investimit, të ardhurave dhe shpenzimeve;
- i. Projektin teknik të ndërhyrjes në zonën publike me vlerë arkeologjike, historike, artistike, kulturore, peizazhit (në rast se aplikohet)
- j. Planin e mirëmbajtjes së saj
- k. Dokumentacion për të vërtetuar eksperiencë nëpërmjet kontratave të ngjashme të mëparshme në ushtrimin e veprimtarisë tregtare;
- l. Vetëdeklarim i subjektit mbi disponimin e kapaciteteve organizative logjistike dhe financiare të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit tregtar shoqëruar me dokumentacionin i cili provon vërtetësinë.

## **B. Shqyrtimi i kërkesës**

1. Kërkesa dhe dokumentacioni shoqëruar i paraqitur nga subjekti kërkues përcillen për vlerësim dhe mendim në:
  - a. Në drejtoritë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, si dhe institucioneve të specializuara në lidhje me përmbajtjen e propozimit dhe zbatueshmërinë e tij.
  - b. Në institucionet të tjera shtetërore në varësi të propozimit dhe kur vlerësohet e nevojshme nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore
2. Në vijim të trajtimit të kërkesës, struktura përgjegjëse për trashëgiminë kulturore në MEKI, shqyrton në rast se aplikimi përmbush listën e dokumentacionit të kërkuar, brenda një afati 5 ditor nga data e ardhjes së dosjes në protokoll. Në rast mosplotësimi të dokumentacionit, aplikanti njoftohet me shkresë përcjellëse.
3. Në rast kur aplikimi është i plotë, struktura përgjegjëse për trashëgiminë kulturore në MEKI dërgon aplikimin për mendim në institucionet e specializuara për trashëgiminë kulturore dhe në institucionet e tjera shtetërore për të cilat nevojitet mendim, me një afat për përgjigje 10 ditor.
4. Në vijim të trajtimit nga strukturat dhe institucionet të parashtruara në pikën 1 të shkronjës B , përgatitet relacioni përmbledhës mbi propozimin, i shoqëruar me mendimet e strukturave dhe institucioneve të sipërpërmendura dhe korrespondencat përkatëse, brenda një afati 5 ditor, të cilat i dërgohen për vendimarrje Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore (KKMPK) dhe Këshillit Kombëtar të Trashëgimise Kulturore Materiale (KTKM).
5. Këshillat përkatës vlerësojnë në lidhje me:
  - a. Këshillin Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore (KKMPK):

- i. Tipologjinë e aktivitetit tregtar dhe shërbimeve që propozohet të zhvillohet
    - ii. Ndikimin që aktiviteti tregtar do të ketë në drejtim të administrimit të pasurisë kulturore
    - iii. Përputhshmërinë e projektit me planin e menaxhimit të pasurisë, në rast se ka
  - b. Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM):
    - i. Vendndodhjen e hapësirës së propozuar nga subjekti kërkues për ushtrimin e aktivitetit tregtar
    - ii. Vlerësimin teknik mbi ndërhyrjet e propozuara në projektin e paraqitur nga kërkuesi dhe ndikimi i tyre në pasurinë kulturore si dhe ndërhyrje të nevojshme në ambientet e propozuara për ushtrimin e aktivitetit tregtar
    - iii. Masat e nevojshme për mbrojtjen dhe ruajtjen e zonës publike me vlerë arkeologjike, historike, artistike, kulturore dhe peizazhi ku do të ushtrohet aktiv
  - c. Në rast se aktiviteti tregtar propozohet në Muze, pjesë e procedurës së vlerësimit dhe këshillimit do të jetë dhe Këshilli Kombëtar i Muzeve (KKM)
6. KKMPK dhe KKTKM shprehen me vendime brenda 60 ditëve nga marrja e kërkesës.
7. Në rast miratimi të kërkesës, urdhri për miratimin përmban si më poshtë vijon:
  - a) Miratimin e kërkesës
  - b) Vendndodhjen dhe sipërfaqen ku do të ushtrohet aktiviteti tregtar, shoqëruar me plan-vendndosjen e cila është pjesë integrale e urdhrit të miratimit dhe kontratës që do të lidhet mes palëve;
  - c) Tipologjinë e aktivitetit tregtar të miratuar
  - d) Detyrimet specifike të subjektit tregtar lidhur me ruajtjen, mbrojtjen dhe vlerësimin e pasurisë kulturore
  - e) Vlerën që duhet të paguajë subjekti tregtar për marrjen në përdorim të pasurisë kulturore.
  - f) Detyrimet e subjektit tregtar për raportim periodik mujor pranë institucionit që ka në përgjegjësi administrimi pasurinë kulturore ku do të zhvillohet aktiviteti tregtar i miratuar
  - g) Të drejtën e Ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore për monitorimin periodik të aktivitetit tregtar të miratuar
8. Për pasuritë kulturore në administrim të institucioneve të tjera shtetërore qendrore ose vendore, ose enteve në varësi të tyre, kërkesa dhe dokumentacioni i sipërpërmendur i dërgohet edhe këtyre institucioneve. Në këtë rast ministria përgjegjëse për trashëgiminë

kulturore e përcjell për mendim kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues në institucionin administrues të pasurisë kulturore, i cili më pas duhet të kthejë përgjigje brenda 10 ditëve.

9. Subjekti administrues i pasurisë shprehet me shkrim dhe arsyetim brenda 10 (dhjetë) ditëve mbi përputhshmërinë e projektit në lidhje me strategjinë ekzistuese të administruesit.
10. Në rast se projekti i propozuar nuk përputhet me strategjinë ekzistuese të subjektit administrues ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore refuzon kërkesën për ushtrimin e aktivitetit tregtar në pasurinë kulturore.
11. Dokumentacioni sipas këtij kreu është pjesë e praktikës administrative të kërkesës dhe ruhet sipas rregullave për ruajtjen e dokumenteve zyrtare dhe arkivave.

## V. DISPOZITAT E FUNDIT

1. Për çdo person fizik ose person juridik, të cilit i është miratuar zhvillimi i aktivitetit tregtar përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, miratimi do Konsidoret sipas datës së fundit të kontratës së lidhur. Brenda këtij afati subjektet duhet të riparaqesin kërkesat në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë Udhëzim. Pas këtij afati, miratimet e aktiviteteve tregtare janë të pavlefshme.
2. Udhëzimi nr. 3067, date 14.06.2016 “Për caktimin e rregullave për krijimin dhe funksionimin e këndeve (souvenir, art & libra “SAL”) për tregtimin e souvenirëve dhe botimeve pranë mjediseve në administrim të Ministrisë së Kulturës dhe institucioneve të saj të varësisë”, shfuqizohet
3. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I TURIZMIT KULTURËS DHE SPORTIT**

**Z. BLENDI GONXHJA**

